



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 1830 Prot.

Tiranë, më 13.03. 2025

U D H Ë Z I M

Nr. 14, Datë 13.03. 2025

PËR

**NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 8, DATË 3.5.2024 "PËR PROCEDURAT E PRANIMIT, TË PEZULLIMIT DHE TË LARGIMIT TË MËSUESIT NGA NJË VEND PUNE, SI DHE ADMINISTRIMIT TË PORTALIT "MËSUES PËR SHQIPËRINË", I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 4, të nenit 60, të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe urdhrin nr. 609, datë 20.12.2024 "Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të arsimit dhe sportit, znj. Orjana Osmani",

U D H Ë Z O J:

1. Në udhëzimin nr. 8, datë 3.5.2024 "Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe të largimit të mësuesit nga një vend pune, si dhe administrimit të portalit "Mësues për Shqipërinë", i ndryshuar, bëhet shtesa, si më poshtë:

a) Pas pikës 2, të Kreut II, shtohet pika 2/1, me përmbajtje, si më poshtë:

*"2/1. Përfshirë, në përbërje të Komisionit të Vlerësimit të Dosjeve (KVD), të ngritur sipas pikës 2 të këtij Kreu, për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve të cilët në aplikimin e tyre kanë përzgjedhur për punësim ZVAP Shkodër, Divjakë, Berat dhe Kolonjë, caktohet edhe nga 1 (një) përfaqësues nga bashkitë e përfshira në projektin pilot në ushtrimin e përgjegjësisë në fushën e arsimit parauniversitar.*

*Kjo përbërje e KVD-së zbatohet sipas kohëzgjatjes së marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet MAS dhe Bashkisë përkatëse."*

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar,

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 23, AL 1001, Tiranë. E-mail: [info@arsimi.gov.al](mailto:info@arsimi.gov.al) [www.arsimi.gov.al](http://www.arsimi.gov.al)

institucionet arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar, Bashkia Shkodër, Bashkia Berat, Bashkia Divjakë, Bashkia Kolonjë dhe institucionet publike të arsimit parauniversitar në territorin e këtyre bashkive.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

**ZËVENDËSMINISTRI**

**ORJANA OSMANI**

